



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 06 janar 2021, në mbledhjen e XLI (dyzet e një) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

E thirrur në kërkesë të 22 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, (kërkesa me nr.prot.01-060/01-0079594/20 të datës 30 dhjetor 2020)

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në ish ndërtesën e Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç z.Blerim Maqastena, i arrestuar, ndaluar dhe i paraburgosur në shtetin e Serbisë, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë, si dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

Rendi i Ditës

➤ Arrestimi nga policia serbe i anëtarit të Kuvendit të Komunës Blerim Maqastena

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit, theksoi, arsyjeja e thirrjes së kësaj seance e dini pasi që i keni marrë materialet me kohë, me kërkesën dhe nënshkrimin e 22 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës me arsyetimin që këshilltari i Kuvendit të Komunës së Podujevës z.Blerim Maqastena është arrestuar nga policia serbe, dhe në shenjë solidarizimi me kolegun si dhe gjetjes së mundësive për mjete materiale nga Komuna që sot të diskutojmë, dhe të nxjerrim një çështje më të mirë për ndodhinë e kolegut, anëtarit dhe qytetarit të Komunës së Podujevës. Ne e dimë që pothuajse që të gjitha organet e Komunës duke filluar prej Kryetarit dhe të gjithë tjerët kanë ngritur zërin por edhe pse pak me vonesë, megjithatë shpresoj që kjo seancë është e arsyeshme dhe unë që nga ky moment e ftoj iniciuesën e kësaj seance anëtarin e kuvendit znj.Tringa Sfishta ta marr fjalën.

znj.Tringa Sfishta, në cilësinë e iniciuesës së kësaj mbledhje, paraqiti fjalë hyrëse, theksoi, para jush do të paraqes arsyet për të cilën është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme. Arsyjeja kryesore mbi të cilën është thirrur kjo seancë mbështetet në arrestimin e këshilltarit dhe kolegut z.Blerim Maqastena nga ana e policisë serbe rreth një muaj më parë dhe heshtjes totale nga ana e të gjitha instancave udhëheqëse të shtetit ton, përveç lajmeve të dhëna nga mediumet tona nuk u ndërmarr asnjë hap në lidhje me këtë arrestim një heshtje e pa shpjegueshme se si nuk është ngrit zëri nga një organ qeverisës duke e marr parasysh që është në pyetje një këshilltar komunal që nënkupton që është i përzgjedhuri i popullit e që automatikisht do të nënkuptonte që do të duhej të ngrihej zëri të

kishte të gjitha kompetentet mbrapa tij duke e mbrojtur dhe duke bërë çmos që sa më parë të lirohej, mirëpo deri më tani nuk kemi marr asnjë veprim konkret nga askush në lidhje me këtë çështje.

Sot përmes kësaj seance do të donim të ngrinim zërin dhe të përçonim një mesazh solidarizues, së pari për kolegun ton dhe familjen e tij në mënyrë që edhe ata të ndjenin përkrahjen e shtetit ton për të cilin kanë dhënë kontribut si familje. Ne si iniciues të kësaj seance kërkojmë nga ana e Komunës së Podujevës përkrahjen së paku me pagesën e shpenzimeve të avokatit dhe t'i dalim në ndihmë, duke marr parasysh edhe gjendjen e rëndë financiare si pasoj e pandemisë e që është reflektuar në secilën nga familjet tona. Duke e marr parasysh edhe buxhetin komunal mendoj se do të ishte e përshtatshme të ndahej një shumë rreth 5.000.00€ nga Zyra e Kryetarit, shumë e cila do ta lehtësonte barrën familjes në lidhje me shpenzimet për këtë rast si dhe në mënyrë indirekte të ndikonte në përshpejtimin e lirimit të kolegut ton z.Blerim Maqastena.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, arrestimi i z.Blerim Maqastena nga policia serbe, në përvojën time politike modeste, ka qenë një ndër momentet më të vështira prej fillimit të mandatit të kësaj legjislature mirëpo si lajm nuk ka qenë i lehtë edhe për shumë qytetarë të Komunës së Podujevës, votuesit e Blerimit si dhe për të gjithë ata që e njohin dhe kanë punuar me Blerimin duke dhënë vlerësime të larta si punëtor, shok i mirë, njëri i fjalës dhe pa qëllime të ulëta, pikërisht nga këtu buron fakti që Blerimi edhe gjatë ditës në të cilën është arrestuar në mënyrë aksidentale ka kaluar në pjesën jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe jo për qëllimet për të cilat mund të pretendohet nga pala tjetër. Arrestimi i z.Blerim Maqastena është arrestim i besimit të shumë qytetarëve të cilët i besuan atij që t'i përfaqësoi në këtë Kuvend dhe trajtimi i kësaj çështje duhet të ketë dimension tjetër si nga ne po ashtu edhe nga institucionet përgjegjëse të sigurisë së vendit.

Nga dikush ndoshta mund të thirret si thirrje e vonuar mirëpo pikërisht tani merr kuptim kjo thirrje ngaqë ne me kujdes e kemi parë angazhimin e institucioneve përkatëse, sikurse të Ministrisë së Punëve të Brendshme që pa pompozitet dhe me ndjeshmëri ka punuar me Organizatat partnere ndërkombëtare të Kosovës që Blerimi të lirohet sa më parë, punë për të cilën familja e Blerim Maqastenes është njoftuar mirëpo nga këtu i ftojmë që të vazhdohet me përkushtim dhe punë të pa rezervë deri në lirimin e Blerimit. Ky është nga momentet e pakta që pa politik e nëpërmes politikës mund të tregojmë që jemi në krahë të njërit tjetrit pavarësisht orientimit politik në momente të vështira si ky pasi që rasti i Blerimit sot mundet të jetë i secilit nga ne nesër.

Grupi i këshilltareve të LDK-së e përshëndet thirrjen e kësaj seance dhe e mbështet rekomandimet apo konkluzat e koordinuara në mes të grupeve të subjekteve tjera.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, jemi këtu në seancën e jashtëzakonshme të thirrur nga 22 Këshilltar Komunal për shokun, kolegun dhe qytetarin e Komunës së Podujevës z.Blerim Maqastena të arrestuar nga policia serbe me datën 12 dhjetor 2020 dhe që po mbahet në qendrën e paraburgimit në Prokuplë. Ne Grupi i LVV-së e mbështesim çdo thirrje dhe çdo iniciativë e cila do ta ndihmonte kolegun ton të lirohej madje edhe do të nënshkruanim për thirrjen e kësaj seance nëse do të na ofrohej kjo mundësi mirëpo ne si Grup i LVV-së nuk kemi qenë të njoftuar. Tani secili mundemi me hedh kritika ndaj njeri-tjetrit mirëpo besoj që të gjithë jemi të mendimit të mirë se si mund t'i dalim në ndihmë kolegut tonë Blerimit, e këtu duhet e mendojmë se çka mund të bëjë Komuna e Podujevës në këtë aspekt kur dihet kompetenca e saj në këtë rast. Komuna ka pasur reagimin e menjëhershëm pas kumtimit të lajmit dhe besoi që është dashur të merret më seriozisht reagimi nga niveli qendror sepse tash kemi të bëjmë shteti me shtet sepse Blerimi, përveç si shok, koleg dhe bashkëvendës i joni mbi të gjitha është qytetar i Kosovës, e ky është skandal ndërshtetëror për faktin se nuk ka bërë asnjë vepër me qëllim të caktuar dhe se moti me mjegull dhe mungesa e sinjalizimit të kufirit ka ndikuar që ta gaboj rrugën e që në fakt ka qenë e njoftuar policia serbe se mund të kenë dalur në pjesën andej kufiri, pra tashmë kanë kaluar edhe kompetencat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe tani

kompetencat janë tek Ministria e Punëve të Jashtme, besoj edhe pse e kemi një Qeveri në detyrë duhet t'i drejtohem Ministrisë së Punëve të Jashtme me një kërkesë nga Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës që të angazhohen maksimalisht Autoritetet Vendore dhe Ndërkombëtare që Blerimi sa më shpejt të jetë e mundur të kthehet në shtëpi shëndosh e mirë. Mirëpo ne duhet të diskutojmë mënyrën se si mund të ndihmojmë Blerimin.

Aq sa jemi të njoftuar nga familjarët e Blerimit nuk kanë qenë në pyetje të hollat apo shuma e caktuar për lirim të tij, por po e përsëris prapë jemi pro çdo iniciative që merret në të mirë të tij, përveç asaj shume financiare që u propozua e që mendoj se ndoshta është e vogël, kemi edhe propozimin që të gjithë asamblistët, mëditjet e kësaj seance t'i ndajmë për në ndihmë Blerimit.

Për fund urojmë që Blerimi sa më parë t'i kthehet familjes, shokëve dhe punës së Kuvendit të Komunës, shumë shpejt e shëndosh e mirë.

z.Fatmir Rudari, theksoi, siç e dimë me datën 12 dhjetor 2020 është arrestuar dhe ndaluar kolegu ynë asamblist z.Blerim Maqastena i cili para së gjithash është qytetarë i Llapit, aktivist i pa lodhshëm i politikave ditore dhe një punëtor i madh për vendin. Me Blerimin ndoshta na ndajnë partitë politike e ndoshta na ndajnë edhe pikëpamjet dhe idetë politike por në rrugëtimin e gjatë shtetërorë e kombëtar nuk na ndanë asgjë, ne që kemi për qëllim forcimin dhe konsolidimin e shtetit tonë çdo ditë e më shumë, pra Blerimi kishte dalë që të ecte pasi që ai e ka pasion ecjen dhe nga mjegulla e madhe ai së bashku me shoqëruesin e tij kishin humbur orientimin dhe ai paraprakisht kishte lajmëruar Policinë e Kosovës për të kërkuar ndihmë e si duket Policia e Kosovës kishte kontaktuar me ata të Serbisë, por Policia e Serbisë në vend që të respektonte të drejtat humanitare, në vend që të respektonte të drejtat e lëvizjes së lirë dhe në vend se të respektonte fqinjësinë ata përdoren vrazhdësinë e mjegullës për të arrestuar dy qytetarë të lirë pa asnjë faj të vetëm por me të vetmin faj se ishin shqiptar. Blerimi u arrestua dhe u burgos padyshim padrejtësisht ngase ai nuk kishte asnjë qëllim të vetëm e asnjë dashje që të kalonte në shtetin Serb e që në situatë konkrete nuk do të mund të ndalohej pasi që mbi të gjitha janë shkelur edhe Konventat Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Njeriut sepse ai pa dijeni, pa dashje dhe pa qëllim ka kaluar në territorin e shtetit tjetër e të cilin shtet Blerimi nuk e ka pasur të ndaluar, pra e gjithë kjo që themi është për tu argumentuar se Blerimi u arrestua, u maltretua dhe u paraburgos e mbahet edhe më tutje padrejtësisht e që për Blerimin dhe familjarët e tij çdo minutë të qëndrimit të tij atje është e madhe por me rëndësi është që çdo minutë dhe sekondë i qëndrimit të Blerimit si i paraburgosur në Serbi është e rënd për shtetin e Kosovës dhe institucionet e saj. Blerim Maqastena dhe familja e tij dëmtohen çdo ditë nga ky paraburgim dhe se Blerimi pa dyshim se do ta përballoj këtë paraburgim dhe se nuk do të ketë frikë nga ajo që çfarë do të ndodh por familja e tij natyrisht që ka shpenzime për tu interesuar për vizitat dhe kontaktet me ndonjë mbrojtës që do të duhej të kishte çdo person i paraburgosur dhe ne duhet të jemi mbështetës të familjes së Blerimit në këtë fatkeqësi të pa pritur dhe të pa qëllimshme derisa Blerimi t'i kthehet Komunës dhe Kosovës. Ne përveç që e përkrahim dhe kërkojmë që të ndahet nga Kryetari ndonjë ndihmë financiare për familjarët e Blerimit që të mbulohen sadopak shpenzimet e domosdoshme, njëkohësisht kërkojmë nga Kryetari i Komunës dhe të gjitha Institucionet vendore e Ndërkombëtare që të kërkohej nga shteti serb të lirohet Blerimi sa më parë që të jetë e mundur.

znj.Mrika Thaqi, theksoi, thirrja e kësaj seance të jashtëzakonshme për anëtarin e Kuvendit z.Blerim Maqastena edhe pse paksa e vonuar për mendimin tim duke u nisur nga fakti që kompetencat tona dihet karshi ngjarjeve të tilla po fundja është njerëzore dhe është kolegiale dhe reflektim rreth rastit të kolegut ton, nga këtu shpreh keqardhje dhe shqetësim për sigurinë qytetare për lëvizjen e lirë dhe trajtimin këso fare të autoriteteve shtetërore serbe por fundja kjo është fytyra e vërtetë e sjelljeve të shtetit serb karshi lëvizjes së lirë. Shqiptaro-fobia Serbe edhe pse jemi në shekullin XXI po manifeston ksenofobinë e tyre. Shqetësim në vete është sjellja e autoriteteve

Shtetërore të Republikës së Kosovës, faktorit Ndërkombëtarë e në veçanti ai Evropian, dëshiroj sa më shpejt t'i kthehet familjes dhe Kuvendit Komunal kolegu Blerim Maqastena. Apeloj te të gjithë kompetentët të bëjnë më shumë për lirin e kolegut tonë Blerim Maqastena, e paçim sa më shpejt këtu në mes nesh në Kuvendin Komunal të Podujevës z.Blerim Maqastena.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, falënderoi disponimin për thirrjen e kësaj seance të jashtëzakonshme për kolegun ton z.Blerim Maqastena dhe disponimin edhe të Kryetarit të Komunës por edhe nga Kuvendi për mbështetje të përgjithshme unanime në vazhdimësi, dhe nga kjo foltore e përshëndes kolegun Blerim edhe pse nuk na dëgjon. Të nderuar koleg në vazhdimësi dhe pa shkëputje fare që nga periudha e masave të dhunshme të Millosheviqit në Kosovë dhe luftës që është zhvilluar nga ky popull nga një regjim totalitar dhe me të njëjtin ritëm dhe qëllim shteti i Serbisë vazhdon provokimet e vazhdueshme ndaj qytetarëve dhe ndaj institucioneve dhe në këtë rast për zgjatjen e arrestimit të kolegut ton Blerim Maqastena se ai shtet dhe ajo qeveri dhe institucionet e saj janë kriminale dëshmon se në krye të atij shteti si president dhe si akteri i Millosheviqit si pjesëmarrës në luftën e drejtpërdrejtë dhe në krimet në Kosovë është Aleksander Vuqiqi dhe ai është kryesori i institucionit i xhandarmërisë dhe i policisë dhe i akterëve kriminal të cilët punojnë me dirigjentët e tyre, kjo për arsye se vet presidenti i Serbisë javën e kaluar deklaroi në mënyrë zyrtare para televizionit publik serb dhe nxori emrat e krimineleve serb të ish oficerëve dhe ushtareve serb me të cilët mundohet që të “lahet” dhe pastrohet para organeve ndërkombëtare por edhe qytetareve të saj, Po ashtu tjetër çka është më shqetësuese kemi reflektimin dhe përgjigjen e drejtpërdrejtë të ish oficerëve serb që iu ishin përmendur emrat nga presidenti Vuqiq dhe deklaruan se në kabinetin e Vuqiqit janë pjesë politike e krimeve që ata kanë kryer, ky është një provokim nga ana e shtetit serb pasi që kolegu ynë mbahet në arrest. Unë uroj për lirin e shokut të tij por nëse është dashur të lirohen është dashur të lirohen dytë, ndalja e Blerim Maqastena është e qëllimshme është tendencioze, është provokatore, për arsye se ai është pjesë e institucionit, ne jemi në mbështetje të plotë të kolegut Blerim dhe të çdo qytetari pa marr parasysh a është i zgjedhur apo qytetar i lirë i Komunës së Podujevës por në këto raste edhe i Republikës së Kosovës. Nga këtu po them edhe një herë edhe në mënyrë personale edhe politike, asnjëherë nuk do të zmbropsmi nga veprimet e njerëzve totalitar që donë të ngritin tensionet për qëllimet e tyre të hapura ndaj qytetareve të Komunës së Podujevës. Ne Grupi i këshilltarëve nga PDK mbështesim në mënyra individuale apo çdo iniciativë në mënyrë të ndershme e them, që e lejon hapësirën e Kryetarit të Komunës së Podujevës, institucionit ton të Kuvendit Komunal, t'i shikojmë të gjitha format që nga hapësira legale, qoftë me mjete financiare apo veprime tjera konkrete brenda kornizës ligjore të shtetit ton që t'i dalim në mbështetje kolegut ton Blerim Maqastena.

z.Bajram Ajeti, theksoi, është për keqardhje domethënë që në atë situatë na erdhi kolegu ynë asamblistë, një qytetar i Llapit dhe i Republikës së Kosovës. Për të hyrë në çështje të marrëdhënieve ndërshtetërore, çështje të kufirit, çështje këto për të cilat unë mendoj se është e tepërt por kisha dashur shkurt rreth propozimit të inicueses së kësaj mbledhje të jashtëzakonshme ishte që shuma për të ndihmuar në mbrojtje juridike të z.Blerim Maqastena të jetë 5,000.00€, unë propozoj që të marrim një vendim që ajo të jetë 6,000.00€ edhe këtë përgjegjësi ta marr Komuna e Podujevës, Administrata Komunale për ta mbuluar normalisht, pastaj kontaktojmë me familjen, familja me mbrojtësin apo si realizimi i atyre mjeteve të jetë i duhur për qëllimin për të cilin edhe ne jemi mbledhur sot.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, mendoj që thirrja e një seance të jashtëzakonshme për rastin e asamblistit ton është mëse e qëlluar dhe besoi që ndoshta ka pasur vend dhe rend që të ketë harmonizim në këtë thirrje edhe më të hershme të kësaj seance por sido qoftë mendoj që është bërë mirë që është thirr kjo seancë. Ne si institucione komunale, si Kryetar i Komunës me të marr lajmin e arrestimit të asamblistit tonë së bashku me një qytetar tjetër, kemi kërkuar informata dhe

kemi vu menjëherë kontakte me Stacionin e Policisë në Podujevë, komandantin e Stacionit, pastaj pas marrjes së informatave konkrete rreth ngjarjes, normal për kundër faktit që kjo çështje nuk i takon nivelit lokal dhe Stacionit Policor të Podujevës, ne kemi pasur informata të mjaftueshme rreth ecurisë së procesit, më pastaj kam vazhduar kontaktin e drejtpërdrejtë me familjen e asamblistit të cilëve iu kemi shprehur po them shqetësimin tonë për mënyrën dhe formën e arrestimit të tij.

Sigurisht që si institucione nuk jemi ndalë vetëm në këtë aspekt, kam vu kontakte edhe në mënyrë indirekte edhe me një ish zyrtar të Komunës së Podujevës që ka qenë deri von përfaqësues i komunitetit serb në mënyrë që të shikohen mundësitë dhe të ketë interesim të drejtpërdrejt rreth gjendjes së asamblistit tonë, formës dhe mënyrës dhe ecurisë së trajtimit të tij dhe sigurisht që kreu këto shqetësime i kemi pasur dhe i kemi përcjellë hap pas hapi, vazhdojmë ti mbajmë kontaktet dhe të interesohemi për fatin e tij. Është e vërtetë që ai është ndaluar për një periudhë kohore 30 ditore dhe sigurisht që tash vazhdon ecuria e procedurave ligjore konform rregullave të shteti serb atje. Besoj që ne si institucione nuk kemi nevojë të kërkojmë që t'i kryejnë punët e veta asnjërit prej Institucioneve në nivelin qendror, ju e dini që tashmë kjo çështje kalon në nivel diplomatik dhe me nivelin diplomatike merret Ministria e Punëve të Jashtme dhe unë besoi shumë dhe informacionet që i kam ata i kanë vu këto kontakte dhe janë në kontakte përmes rrugëve diplomatike me shtetin serb në mënyrë që të bëhet lirimi sa më parë i asamblistit në fjalë, i cili shpresojmë shumë që do të lirohet shpejt dhe ajo që është me rëndësi gjendja shëndetësore e asamblistit është e mirë, nuk ka pasur ndonjë keqtrajtim gjatë fazës së arrestimit të tyre, përfshirë edhe qytetarin që kanë qenë bashkë i cili pastaj është liruar, prandaj ne si institucione komunale që jemi, domosdoshmërisht jemi në mbështetje të çfarëdo vendimi që nxjerr ky Kuvend.

U dhanë propozime të ndryshme sa i përket mbështetjes financiare për familjen e asamblistit në fjalë, njëri ishte 5,000.00€ nga iniciuesja e kësaj seance, pastaj asamblisti z.Bajram Ajeti propozoi që mbështetja financiare të jetë 6,000.00€, mandje ishte edhe propozimi tjetër i asambleistës që mëditjet e këshilltarëve nga kjo seancë të destinohen ndihmë për asamblistin e arrestuar, por unë ju lus që të ketë një vendim, çfarëdo qoftë ai, ne si institucion jemi të gatshëm që ta përfillim, pra të merret është mirë të merret një vendim, jo të shkohet me rekomandim, dhe ne konform atij vendimi do të realizojmë në afatin sa më të shpejtë të mundshëm bartjen e atyre mjeteve në xhirollogarinë e familjes së asamblistit në mënyrë që asamblistit tonë sa do pak t'i dilet në ndihmë me shpresën që sa më shpejt të jetë e mundur t'i kthehet familjes dhe vendit.

z.Fatmir Rudari, theksoi, falënderoj Kryetari e Komunës për gatishmërinë që e shprehi për ta mbështetur çdo vendim të Kuvendit të Komunës lidhur me çështjen për të cilën po diskutojmë. Edhe unë pajtohem me propozimin e z.Bajram Ajetit që shuma të jetë 6,000.00€ dhe ne do ta përkrahim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, rreth kësaj çështje veçse u paraqiten qëndrimet e secilit dhe u arrit një unanimitet, patëm edhe propozimin e z.Bajram Ajetit që shuma e mbështetjes të jetë 6,000.00€, mandej ishte edhe propozimi i këshilltares përkatëse që mëditjet e kësaj seance të shkojnë ndihmë për kolegun tonë. Konsideroj se do të ishte mirë që përfaqësuesit e Grupeve të këshilltarëve dhe subjekteve politike të konsultohen për disa minuta dhe të dalin me një qëndrim unanim, dhe pastaj ta vëmë në votim.

znj.Tringa Sfishta, theksoi, unë e propozova shumën 5,000.00€ për shkak se mua më është thënë që nuk lejohet shumë më e madhe nga Zyra e Kryetarit, mirëpo unë jam për edhe për shumën e propozuar prej 6,000.00€, por edhe për ndonjë shumë më të madhe, nuk paraqet problem.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financa-DBF, theksoi, e përshëndes këtë iniciativë për t'i ndihmuar kolegut tonë Blerim Maqastena përmes Kuvendit Komunal i cili nëse merr vendim për 6,000.00€ është në rregull sepse e ka atë të drejtë, mirëpo me qëllim të lehtësimit të procedimit të pagesës, është mirë që ndarja e mjeteve të shkojë për ndihmë familjen e asamblistit në

fjalë sepse në qoftë se marrim vendim për me i kry shërbime të avokaturës ne kalojmë në detyrime me kontrakt shërbim, në qoftë se shkojmë direkt familjes, pastaj familja e angazhon këdo që e ka vullnetin dhe dëshirën.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, a jeni dakord që ndihma të shkoj në emër të familjes dhe shuma të jetë 6,000.00€, e hedh në votim.

Pas votimi, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 6,000.00€, ndihmë për familjen e Blerim Maqastena, nga fshati Dumosh, Komuna e Podujevës, anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, i arrestuar, ndaluar dhe paraburgosur nga policia e shtetit Serb në kufirin Kosovë – Serbi më datë 12.12.2020, mjete të cilat destinohen me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të familjes deri sa i përmenduri qëndron në mbajtje në shtetin Serb, si dhe shuma e ndarë t'i transferohet përmes xhironlogarisë bankare ndonjërit prej familjarëve të të përmendurit.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0000846/21

Podujevë,

06 janar 2021

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi